



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

### V E N D I M

**Nr. 22/2, DATË 20/11/ 2017**

#### **PËR MOSPRANIM TË KËRKESËS PËR PËRFITIM TË STATUSIT “INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E VEÇANTË” PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT “VALA MARE II”**

Në mbështetje të Nenit 9, pikës 5 të nenit 17 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Kreu I, pika 3/c të VKM Nr. 1023, datë 16.12.2015 dhe Kreut II, pika 8, 10 e VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015, Komiteti i Investimeve Strategjike,

#### VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës për përfshirjen e projektit investues “Vala Mare II”, me subjekt investues “MANE TCI” Shpk, NIPT/NUIS :K22203004A, në Hamallaj, Gjiri i Lalzit, Durrës, ZK.1925, në “procedurën e veçantë”, për mungesë të strukturave akomoduese turistike në projektin Vala Mare II, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit të turizmit në fuqi.
2. Vendimi i KIS publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet me shkrim kërkuarit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **ZËVENDËSKRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

#### **ZËVENDËSKRYEMINISTËR**

SENIDA MESI